

Bastisen dy prona në Podujevë, arrestohet një person e sekuestrohen armë dhe substanca narkotike



Raporton: Florentina OSMANI
 Gusht 21, 2020

Podujevë – Policia e Kosovës (PK) ka arrestuar një person në Podujevë, si dhe ka sekuestruar armë të kalibrave të ndryshëm dhe substanca narkotike.

Sipas raportit të PK-së, deri të sekuestrimi në fjalë ka ardhur pas urdhëresës së gjykatës për bastisjen e shtëpive dhe objekteve përcjellëse në dy lokacione, në pronësi të dy të dyshuarve, raporton “Betimi për Drejtësi”.

Bëhet e ditur se i dyshuari për këtë rast është liruar në procedurë të rregullt.

“Podujevë 20.08.2020-09:10. Në bazë të urdhëresës së gjykatës, në dy lokacione janë bastisur shtëpitë me objekte përcjellëse, prona të dy të dyshuarve meshkuj. Gjatë bastisjes janë gjetur dhe sekuestruar: një pushkë automatike me 5 fishekë të kal.7.62 mm, një pushkë gjuetie me dylbi me 2 fishek të kal.7mm, 2 fishekë te kal.12 mm një karikator i pistoletës, një palë dylbi te pushkës së gjuetisë dhe një qese e najlonit me substanca te dyshuara narkotike me peshë rreth 2.1 gram. Lidhur me rastin është arrestuar një i dyshuar mashkull kosovar i cili pas intervistimit me urdhër të prokurorit është liruar në procedurë të rregullt”, thuhet në raportin e PK-së. **/BetimipërDrejtësi**

EMISIONI I FUNDIT



Qasja e Komisionit për Legjislacion për sundimin e ligjit

13 Qershor, 2020

EMISIONET E FUNDIT




Prioritetet e Ministrisë së Drejtësisë

6 Qershor, 2020



Kush e mbron privatësinë në Kosovë?

30 Maj, 2020



Programi për kompensimin e viktimave të krimit

23 Maj, 2020

[shiko të gjitha ⇨](#)

VEGZA DIREKTE

Insituti i Kosovës për Drejtësi
 Radio Televizioni i Kosovës

BASHKOHU ME NE NË:



Copyright © Betimi për Drejtësi. Asnjë material apo informacion i publikuar në këtë faqe nuk mund të kopjohet, të shtypet, ose të përdoret në çfarëdo forme tjetër për çfarëdo qëllimi pa respektuar të drejtat e autorit. Kushdo që dëshiron t'i referohet emisioneve apo shkrimeve të publikuara në portalin “Betimi për Drejtësi”, duhet të marrë paraprakisht lejen nga autori. Deri në 30 % të shkrimit mund të merret, vetëm nëse artikulli përmban referencën e saktë të portalit “Betimi për Drejtësi”. Emisionet dhe shkrimet mund të ripublikohen në marrëveshje me redaksinë. Çdo shkelje në drejtim të drejtave të autorit do të ndiqet përmes rrugës ligjore.